



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Mbledhja nr.13/24

Prishtinë, më 19.6.2024, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë Armend Muja, Enver Haliti, Visar Korenica, Eman Rrahmani, Avdullah Hoti dhe Duda Balje.

Të ftuar: Besnik Boletini, Shkumbin Ahmetxhekaj, Albulena Mehmeti, Fatime Lumi-Qehaja, Dardan Beqiri, Birol Urcan, Arta Berisha, Gazmend Reshitaj dhe Safet Kabashaj.

Pjesëmarrë të tjerë Diar Beqaj D+, Vlora Shabani Kallxo.com, Ema Krasniqi KDI, Valmire Abedinaj EO dhe Shqipe Pajaziti, KosovaPress.

Stafi mbështetës i Komisionit Sabrije Saliuki-Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli, dhe Diar Beqaj, praktikant në Kuvend.

Mbledhjen e kryesoi Armend Muja, kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë: 8.5.2024, 15.5.2024 dhe 22.05.2024;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2023;**
- 4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2024;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2023;**
- 6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfere 2025/01;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, konstatoi se me shumicë votash komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më datë: 8.5.2024, 15.5.2024 dhe 22.05.2024

Kryetari, pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë ndonjë vërejtje në procesverbalet e datës 8.5.2024, 15.5.2024 dhe 22.05.2024:

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, u miratuan procesverbalet e mbledhjeve së Komisionit të mbajtura më 8.5.2024, 15.5.2024 dhe 22.05.2024 **(pa vërejtje)**.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar i Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2023;

Kryetari, Në bazë të nenit 98 paragrafi 3 i Rregullores së Kuvendit, Komisioni përgjegjës-raportues shqyrton raportin vjetor të organit të pavarur dhe i paraqet raport me rekomandime Kuvendit, pasi që raporti financiar dhe ai i auditimit të atij organi të jetë shqyrtuar nga komisionet përkatëse dhe t'i jenë proceduar Komisionit funksional.

Në bazë të nenit 30, paragrafi 8 dhe 9 të Ligji nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës, Radiotelevizioni i Kosovës i raporton Kuvendit në baza vjetore.

Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka dërguar raportin vjetor për vitin 2023 në Kuvend dhe Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere është ngarkuar që të shqyrtojë Raportin financiar të këtij institucioni

dhe të paraqes raportin me rekomandime.

Në lidhje me këtë pikë, e kemi ftuar kryetarin e Bordit të RTK-së , z. Besnik Boletinin, nga i cili kërkojmë që të arsyetojë raportin dhe pastaj do të hapim diskutimet për anëtarët e komisionit.

Pyetjet e parashtruara nga deputetët:

Eman Rrahmani: Krahasimi i punëtorëve të rregullt dhe atyre të kontraktuar për shërbime në vitin 2021 dhe 2023, kërkoj informacion të saktë.

Avdullah Hoti: Shpenzimet e juaja, a janë në përputhje me ligjet në fuqi, ndërsa edhe procedurat e prokurimit a kanë qenë në përputhje me ligjet?

Kryetari: Përmes kompensimit si formë të marketingut, ju e keni të pamundur ta dini vlerën e kontratës, si dhe ZKA-ja ju ka rekomanduar që ta ndaloni këtë veprimtari, çka është bërë në këtë drejtim? Sepse nga deklaratat e juaja ka pasur edhe ndryshime përmbajtjesore të rregullores së marketingut?

Kryetari: Kërkoi metodologjinë e kontratave për kompensim si dhe listën e tyre.

Visar Korenica: Pse nuk është bërë ende pagesa e licencës nga KPM-ja?

Avdullah Hoti dhe Eman Rrahmani: Listën e shpenzimeve të derivateve, dhe shpenzimet e derivateve nga menaxhmenti i lartë?

Eman Rrahmani: Kërkoi sqarim për çështjen e mosevidentimit të menaxhmentit të lartë në vijoren e punës?

Kryetari: Sa janë mbledhur para kesh në 3 vitet paraprake (kesh + kompensim), si dhe kërkoi përgjigje institucionale për të gjitha gjetjet e raportit të ZKA-së.

Raportimi i RTK-së shtyhet për mbledhjen e javës tjetër (28.6.2024) për shkak të mungesës së kuorumit dhe pyetjeve të deputetëve!

4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2024;

Shqyrtimi shtyhet për shkak të mungesës së kuorumit.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2023;

(Votimi për këtë pikë do të bëhet pas pranimit të raportit të auditimit për KRPP-në, nga Zyra e Kombëtare e Auditimit).

6. Shqyrtimi i kërkesës buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2025, në bazë të Qarkores së parë buxhetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfere 2025/01;

Kjo pikë shtyhet për një mbledhje tjetër.

7. Të ndryshme

Meqë nuk pati çështje të tjera të ngritura:

Kryetari e përfundoi mbledhjen në orën 13:35.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Armend Muja

Kryetar i Komisionit